

Statuti
I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
" ALTAR SERVICE " shpk

Ne bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 'Për qendrën kombëtare të biznesit ' sot më datë 10/09/2023, ne të nënshkruarit:

1- Ari Shkëmbi , shtetas Shqiptar , i biri i Jani , lindur më 12/03/1979 në Videhovë, Devoll, Korçë dhe banues në Zham Sektor , Lushnje, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035037225, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i parë** ») ; dhe

2- Altin Këlliçi, shtetas Shqiptar ,i biri i Dalip , lindur më 17/05/1975 në Kavajë dhe banues në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033273731, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i dyte** »)

themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar nëfuqi,dhe në kushtet e përcaktuara në këtë Statut :



KREU I
EMERTIMI-SELIA-OBJEKTI-KOHEZGJATJA

Neni 1- Emërtimi

- 1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.Emërtimi i shoqërisë është « **ALTAR SERVICE** » Sh.p.k. (në vijim « Shoqëria »).Shoqëria do të fitojë personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- 1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin nr.9901 « Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare » të ndryshuar,legjislacionit shqiptar në fuqi,dhe në këtë Statut.

Neni 2-Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën :
Kavaje, Shtodher me Nr.Pasurie 44/13 ne Z.Kadastrale 3427



2.2 Shoqëria mund të krijojë degë, zyrë, filiale dhe të zhvilloj aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë.

Neni 3-Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

- 3.1 Servis kamionash, vincash, autobote dhe mjete të tjera të rënda. Ndryshime konstruktive të mjeteve. Lyerje dhe pastrime të automjeteve dhe cisternave të ndryshme. Shitblerje mjeteve, të reja dhe të përdorura. Shërbime karoatreci. Import – eksport automjeteve të ndryshme. Tregti pjesë këmbimi, bojra dhe aksesori të ndryshëm për automjete. Ndërtime banesa dhe rikonstruksione të ndryshme banesash, pallate dhe hotele. Karpentier. Përpunim dhe lidhje hekuri . Suvatime të brendshme dhe të jashtme. Lyerje të brendshme dhe të jashtme, shtrim pllakash, mermer dhe parkete . Punime çatie me tjegulla dhe druri, punime elektrike dhe hidraulike . Punime murature, gërmime dheu, hedhje betoni, hidroizolime . Dekore fasadash dhe veshje të ndryshme fasadash. Punime duroalumini. Punime të ndryshme ndërtimi. Ndërtime struktura parafabrikate prej betonarme, druri dhe metalike. Gërmim dheu, pilota, diafragma, ankorime, mure mbajtëse, stabilizim skarpate dhe përforcim dhera. Punime për prishjen e ndërtimeve. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave me mjetet e vetë shoqërisë, për llogari të saj, të të tretëve dhe me qera. Transport të mallrave me mjete jashtë norme dhe shoqërim teknik të tyre. Import-export dhe tregëtim me shumicë dhe/ose pakicë të pajisjeve dhe materialeve të ndërtimit, industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, hidraulike, elektrike, elektronike, drusore, pjesë këmbimi të reja dhe përdorura, brenda dhe jashtë vendit.
- 3.2 Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji, për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Neni 4-Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar të Republikës së Shqipërisë.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

KREU II KAPITALI

Neni 5-Kapitali



- 5.1 Kapitali themeltar I shoqërisë është 40.000.000 lekë (dyzet milion), I cili ndahet në 2 kuota,të cilat zotërohen nga ortakët e saj.Kapitali themeltar është i nënshkruar nga ortakët.
- 5.2 Kapitali themeltar apo cdo kontribut në para, për zmadhimin e kapitalit paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 5.3 Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 Ortakët

- 6.1 Ortakët e Shoqërisë janë si vijon :
- a)) Ari Shkëmbi , shtetas Shqiptar , i biri i Jani, lindur më 12/03/1979 në Videhovë, Devoll, Korçë dhe banues në Zham Sektor , Lushnje, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035037225, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i parë** »)
- Ortaku i parë zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 20.000.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblenë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.
- b- Altin Këlliçi, shtetas Shqiptar ,i biri i Dalip , lindur më 17/05/1975 në Kavajë dhe banues në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033273731, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i dyte** »)
- Ortaku i dytë zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 20.000.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblenë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.
- Ne vijim të dy ortakët bashkarisht do të referohen si « Ortakët ».
- 6.2 Adresa e ortakëve për efekt të marrëdhënies midis tyre me Shoqërinë ,është ajo që rezulton nga regjistri i ortakëve.Eshtë detyrim i ortakëve të njoftojnë ndryshimin e adresës së tyre.
- Administratori ka për detyrë të mbajë dhe të përditësojë këtë regjistër.

Neni 7-Kontributet dhe Financimet

- 7.1 Kontributi i ortakëve në kapitalin e Shoqërisë do të jetë ne para .
- 7.2 Shoqëria, me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi,mund të grumbulloj financime nga ortakët, me të drejtë kthimi, jo detyrimisht në përpjestim me kuotat e pjesmarrjes te secilit, në kapitalin e Shoqërisë. Përveç kur parashikohet në mënyrë specifike nga asambleja e përgjithëshme e ortakëve, financimet e ortakëve në favor të Shoqërisë do të konsiderohen pa qëllim fitimi.

Neni 8-Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave



1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 9 - Pasojat e kalimit të kuotave dhe pjesëtimi dhe transferimi i tyre

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.
2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
3. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.
4. Dispozitat e nenit 73 të këtij ligji për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

KREU III MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

Neni 10- Shpërndarja e fitimeve

- 10.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.



KREU IV



ORGANET E SHOQERISE

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

Neni 11- Të drejtat dhe detyrimet

11.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjitheshme e ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë . Ajo përfaqëson të gjithë ortakët , dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, përfshirë ata që nuk marrin pjesë në votim dhe që votojnë kundër këtyre vendimeve.

11.2 Asambleja e pergjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.3 Asambleja e pergjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Neni 12-Përfaqësimi dhe Kuorumi

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamblenë e pergjitheshme dhe të votojë sipas kuotave që zotëron në kapitalin e nënshkruar e të shlyer të Shoqërisë.

12.2 Ortakët nuk mund të përfaqësohen në asamblenë e pergjitheshme nga një ortak tjetër apo një person i tretë.

12.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, asambleja e pergjitheshme e ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme, kur në mbledhje marrin pjesë ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë jo më pak se 70% (shtatëdhjetë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me votat pro, të më shumë se 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të ortakëve të pranishëm.



Vendimi i emërimit dhe shkarkimit të Administratorit të Shoqërisë, do të quhet i vlefshëm kur merr votat pro, të më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të ortakëve.

12.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, ajo mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13-Thirrja e asamblesë së përgjithshme

13.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mbledhet në mënyrë të rregullt dhe të detyrueshme të paktën 2 herë në vit dhe mund të thirret në çdo kohë sipas parashikimeve të nenëve 82,83 dhe 84 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

13.2 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mbledhet në selinë ligjore apo pranë një vendi tjetër brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë.

13.3 Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të ortakëve thirret me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar me postë të regjistruar ose nëpërmjet postës elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të tregojë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe do të dërgohet secilit ortak, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Gjithashtu, njoftimi duhet të përmbajë, edhe mënyrën e pjesmarrjes në asamblesë të ortakëve dhe/ose mënyrën e vendimarrjes.

13.4 Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe vendimet e saj janë të vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjesë të gjithë ortakët që përfaqësojnë kapitalin e Shoqërisë.

13.5 Asambleja e përgjithshme e ortakëve kryesohet nga personi i emëruar nga shumica e ortakëve pjesmarrës (në vijim i quajtur "kryetari i Mbledhjes").

13.6 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunikime video-shkrues.

13.7 Të gjitha njoftimet, kërkesat, paditë, apo komunikimet e tjera do të bëhen në formë të shkruar dhe do të jepen apo nisen (dhe do të konsiderohen sikur janë dërguar në mënyrë të duhur ose kryer në momentin e marrjes) tek ortakët përkatës në adresat e mësipërme.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14 - Administrimi i Shoqërisë

14.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet vetëm nga administratori i Shoqërisë i emëruar me shumicë të thjeshtë/të zakonshme të votave në asamblesë të përgjithshme të ortakëve sipas parashikimeve të nenit 12.3 të Statutit.

14.2 Administratori i Shoqërisë do të emërohet nga asambleja e përgjithshme e ortakëve dhe mund të shkarkohet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

14.3 Afati i emërimit të Administratorit të Shoqërisë do të caktohet, në momentin e emërimit të tij por jo më i gjatë se 5 (pesë) vite. Pa cënuar këtë kufizim afati, emërimi i administratorit mund të ripërtërihet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

14.4 Në rast dorëheqje, Administratori do të njoftoj me shkrim asamblesë e përgjithshme të ortakëve. Dorëheqja hyn në fuqi në momentin e emërimit të Administratorit të ri.

14.5 Administratori do të administrojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë, në përputhje me këtë Statut dhe Legjislacionin në fuqi.

Neni 15-Emerimi, kompetencat e Administratorit

15.1 Administrator i Shoqërisë do të jetë: Ari Shkëmbi, shtetas Shqiptar, i biri i Jani, lindur më 12/03/1979 në Videhovë, Devoll, Korçë dhe banues në Zham Sektor, Lushnje, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035037225, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili do të emërohet për një mandat fillestar 5 (pesë) vjeçar me të drejtë ri-emërimi.

15.2 Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe do të përfaqësoj Shoqërinë kundrejt palëve të treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose të ligjit të zbatueshëm. Administratori ka kompetenca të plota për të marrë vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç kompetencave që do të ushtrohen nga organe të tjera të Shoqërisë sipas këtij Statuti ose ligjit të zbatueshëm.

15.3 Administratori do të ketë këto kompetenca dhe detyra që lidhen me administrimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë, duke përfshirë dhe mos u kufizuar, si më poshtë:

- a) të zbatoj politikat tregtare të Shoqërisë, si dhe vendimet e asamblese së përgjithshme;
- b) të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- c) të përfaqësoj Shoqërinë kundrejt palëve të treta;
- ç) të sigurojë mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të ortakëve, nëse e vlerëson të nevojshëm për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- dh) të përgatis dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ti paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) të kryej regjistrimet dhe të dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- ë) të punësoj ose të nderpres marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të Shoqërisë;
- f) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare

dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

g) të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

gj) të emëroj përfaqësuesin në gjykatë të shoqërisë.

15.4 Administratori mund të ushtroj të gjitha kompetencat si dhe të kryejë të gjitha veprimet të cilat me ligj ose nga ky Statut, nuk i rezervohen kompetencave të asamblesë së përgjithshme të ortakëve ose nuk kufizohen nga ky Statut apo nga ligjit i zbatueshëm.

KREU V VITI FINANCIAR

Neni 16- Viti Financiar

16.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Viti I parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

16.2 Miratimi I dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhen brenda 6 muajve që nga fundi I vitit financiar.

Neni 17-Bilanci dhe fitimet

Veprimtaria ekonomike do të mbyllet në 31 dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim-humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten I kalojnë ortakëve të shoqërisë, të cilët vendosin se cdo bëhet me këto fonde.

Neni 18-Kontrolli Kontabel

Nëse kërkohet nga Ligji, ekspertit dhe /ose ekspertët emërohen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve. Asambleja e ortakëve mund të riemëroj të njëjtin/ët ekspert/ë. Eksperti/ët shkarkohet/en nga detyra me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve në rast mosrespektimi të detyrës së tij, në rast gabimi dhe në rast mungese profesionalizmi në sjellje.

KREU VI



PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 19-Prishja dhe Likujdimi

19.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendos për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likujdimin e saj.

19.2 Likujduesi/t do të emërohen me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Emërimi i likujduesit/eve dhe procesi i likujdimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

Neni 20-Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

20.1 Për çështjet e parregulluara në këtë Statut do të zbatohet Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", i ndryshuar.

20.2 Çdo konflikt, divergjencë, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdo lloji, sido që të ketë lindur nga/ apo në lidhje me këtë Statut, do t'i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut i Shoqërisë u hartua në dy kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë.

ORTAKET

Ari Shkëmbi



Altin Këlliçi

